



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**VENDIM**

**Nr. 7 / 8, datë 30 / 10 / 2023**

**PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIMIN E STATUSIT “INVESTIM/  
INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E VEÇANTË”  
PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT “IMPIANT FOTOVOLTAIK 150 MWP (AC)  
AGA SOLAR PARK”, ME SUBJEKT APLIKUES SHOQËRINË “AGA SOLAR”  
SHPK, ME NUIS/NIPT: M11415029E**

Në mbështetje të neneve 9, 13, dhe 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreu I, pika 3/a të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi” dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike vlerësoi se:

- Projekti i investimit propozon zhvillimin e një Parku Fotovoltaik me fuqi 150 MWp, vendosur në fshatin Darëzezë e Re, Bashkia Fier.
- Vlera e investimit për projektin e propozuar parashikohet të jetë 176,479,000 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milion e katëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë) Euro.
- Pasuritë e paluajtshme të pretenduara “shtet” që preken nga projekti i investimit ndodhen në ZK Nr. 1451.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

**KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**  
**VENDOSI:**

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “Impiant Fotovoltaik 150 Mwp (AC) Aga Solar Park”, në procedurën e veçantë dhe mbështetjen që ofron ky status.
2. Zona e projektit ka regjistrim pjesor kadastral, mospërfundimi i të cilit pengon marrjen e veprimeve të mëtejshme ligjore nga ana e institucioneve.

3. Projekti i propozuar është në mospërputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Fier.
4. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**KRYEMINISTËR**

**EDI RAMA**